

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot në datë 01/02/2024, lidhet kjo kontratë shitje kuotash ndërmjet palëve të mëposhtme:

### **PALA DHURUESE :**

1. **Elion Sulkaj** me ID me nr I90824061E, shtetas Shqiptar , lindur me 24/08/2089 ne Fier, banues ne Tirane, Shqiperi, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar, ortak i shoqërisë “Elmaer Pharma” sh.p.k (NIPT M31712027H), që merr pjesë në shoqëri me 50 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë .
2. **Marinel Sulkaj** me ID me nr J10212062T, shtetas Shqiptar , lindur me 12/02/1991 ne Patos, banues ne Tirane, Shqiperi, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar, ortak i shoqërisë “Elmaer Pharma” sh.p.k (NIPT M31712027H), që merr pjesë në shoqëri me 25 % të kuotave në kapitalin themeltar ose me 1 (një) pjesë .

**PALA Pranuese :** Z. Erlis Sulkaj mbajtes i ID J30124049F , lindur me 24/011993 ne Fier,shtetas Shqiptar , banues ne Tirane, Shqiperi , madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar.

**OBJEKTI I KONTRATËS:** Dhurimi i 1(nje) kuote e barazvlefshme me 50 % të kapitalit që Dhuruesi Z.Elion Sulkaj zotëron në shoqërinë “ Pro Health” sh.p.k (NIPT M31325042L)

Dhurimi i 1(nje) kuote e barazvlefshme me 25 % të kapitalit që Dhuruesi Z.Marinel Sulkaj zotëron në shoqërinë “ Pro Health” sh.p.k (NIPT M31325042L)

**BAZA LIGJORE:** Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (neni 705 e vijues), Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe Statuti i shoqërisë “**Elmaer Pharma ” shpk**

Nga deklaratimet e palëve të mësipërme dhe nga dokumentet e paraqitura rrjedh se:

- a) Elion Sulkaj është ortak 50 % të shoqërisë “Elmaer Pharma“ SHPK, me seli ne Tirane Rruga "Artan Lenja", nr pasurie 1/227-G1,Hyrja -1 Garazh,, eshte regjistruar si person juridik me date **04/05/2023**, prane Qendres Kombetare te Biznesit (Q.K.B), me numer identifikimi NIPT-i **M31712027H**, me kapital të shoqërisë prej 100,000 (Njeqind mije ) lekë. Në këtë kapital ai zotëron 1 (një) pjesë dhe 50 (njeqind ) % të kapitalit të shoqërisë;  
Marinel Sulkaj është ortak 25 % të shoqërisë “Elmaer Pharma“ SHPK, me seli ne Tirane Rruga "Artan Lenja", nr pasurie 1/227-G1,Hyrja -1 Garazh,, eshte regjistruar si person juridik me date **04/05/2023**, prane Qendres Kombetare te Biznesit (Q.K.B), me numer identifikimi NIPT-i **M31712027H**, me kapital të shoqërisë prej 100,000 (Njeqind mije ) lekë. Në këtë kapital ai zotëron 1 (një) pjesë dhe 25 (njeqind ) % të kapitalit të shoqërisë;
- b) **Z . Elion Sulkaj** deklaron se 1 kuotë të tij në shoqëri (e që përbëjnë një pjesë dhe 50 % të kapitalit të shoqërisë) ai ka ndër mend ta dhuroje ne favor te Erlis Sulkaj.

**Z. Marinel Sulkaj** deklaron se 1 kuotë të tij në shoqëri (e që përbëjnë një pjesë dhe 25 % të kapitalit të shoqërisë) ai ka ndër mend ta dhuroje ne favor te Erlis Sulkaj.

c) **Z. Erlis Sulkaj** ka shprehur dëshirën e tij për te pranuar kuotat ;

d) Ky veprim i dhurimit të kuotave është miratuar nga asambleja e ortakëve të shoqërisë me vendimin përkatës.

**DEKLARIME DHE GARANCI** : Palet dhuruese deklarojne dhe garantojne palen panuese :

- Dhuruesit deklarojne dhe garantojne panuesin se pjesët (kuotat) e kapitalit të shoqërisë objekt i kësaj kontrate janë të transferueshme dhe të lira nga cdo barrë hipoteke, apo cdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- Ne cilesine e ortakëve të shoqërisë “Elmaer Pharma “ shpk nuk kane shitur, dhuruar, premtuar për shitje, dhene si garanci apo ne cdo lloj forme tjetër te kete disponuar mbi pjese te kuotes se kapitalit apo asetëve të shoqërisë.

- Ne cilesine e ortakëve të shoqërisë garantojne panuesin se shoqëria., nuk ka asnjë borxh ndaj institucione shtetërore si taksa, tatime, apo pale te treta private perfshire Bankat qe mund te coje ne uljen e vleres se kuotes se dhuruar .

- Pala dhuruese deklaron se me nënshkrimin e kesaj marreveshjeje nuk ka asnjë pretendim te tanishem apo te mevonshem te asnjë lloji per dhurimin e kuotes duke e konsideruar ate te drejte dhe te sakte.

Pala pranuese Blerese deklaron dhe garanton dhuruesin se:

- Nuk ka asnjë pengese per lidhjen e kesaj kontrate dhurimi .

**Z. Marinel Sulkaj** deklaron se eshte njohur me aktet e shoqërisë dhe me gjendjen ekonomike e financiare të saj dhe deklarojne se si ortakë të shoqërisë përgjigjet sipas ligjit për të gjitha detyrimet e shoqërisë ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve lidhur me këtë kalim pronësie, përfshirë dhe detyrimet e mëparshme.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhurimi , Pala dhuruese Elion Sulkaj e humbet 50 % dhe Marinel Sulkaj 25% te kuotave qe dhuruan në kapitalin e shoqërisë “Elmaer Pharma” sh.p.k. dhe zotërues i 75 % të tyre bëhet z. Erlis Sulkaj me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ky kalim pronësie,duke u bere aktualisht zoterues i 100% te kuotave te shoqërisë(25% ishte zoterues dhe 85% te tjera u shtuan nga kjo kontrate dhurimi.

Pas këtij akti dhurimi kuotash, shoqëria e lartpërmendur ka 1 (nje ) ortak dhe pikërisht:

1. **Z. ERLIS Sulkaj** në kapitalin e shoqërisë zotëron 1 (një) pjesë dhe 10 (NJEQIND) % të kapitalit të shoqërisë me vlere 100,000 (Njeqindmije) Lek

**ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE** :Palët bien dakord që cdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi dhe ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes palëve. Në rast se bisedimet nuk japin rezultat atëherë konflikti do të zgjidhet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, Shqipëri.

**HYRJA NE FUQI** :Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

Kontrata përpilohet në 2 kopje të njëjta në gjuhën shqipe me vleret te njejte ligjore dhe pasi lexohet nga palet dhe pasi u gjendet ne përputhje te plote me vullnetin e paleve kontraktuese nënshkruhet rregullisht prej tyre personalisht sipas ligjit.

### **PALËT KONTRAKTUESE**

**PALA DHURUESE**

**Elion Sulkaj**  


**Marinel Sulkaj**



**PALA PRANUESE**

**Erlis Sulkaj**

